



SOT MBAHET SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT, LV-ja DHE LDK-ja SHKOJNË PA MARRËVESHJE PËR INSTITUCIONET E REJA

FAQE 3



Sot (e enjte) mbahet seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës, ndërsa partitë politike shkojnë në këtë proces pa një marrëveshje për formimin e institucioneve të reja. Lëvizja

Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nuk kanë arritur pajtim pas takimit treorësh mes Albin Kurtit dhe Lumir Abdixhikut, por kanë paralajmëruar vazhdimin e

negociatave. Derisa LDK-ja nuk ka shprehur ambicie për pozitën e kryetarit të Kuvendit, LV-ja pritet ta propozoj serish Albulena Haxhiun për kryeparlamentare

MEDIET NDËRKOMBËTARE RAPORTOJNË PËR GJETJET E FUNDIT TË VARREZAVE MASIVE NË ZUBIN POTOK

F. 7



SHBA-ja: HUAJA PREJ 302 MILIONË DOLLARËSH FORCON KAPACITETET MBROJTËSE TË SHQIPËRISË

F. 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROLKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



KGJK-ja NESËR SHOYRTON DORËHEQJET E GJYQARËVE DHE STAFIT SERB

F. 7

ALIU INTERVISTOHET NGA PROKURORIA SPECIALE: KAM VEPRUAR NË PËRPUTHJE ME LIGJIN, NDIHEM I LEHTËSUAR

F. 5

KUSARI-LILA MIRËPRET 15 INSPEKTORË TË RINJ: SYNOJMË T'I RRSIM NË 100 DERI NË FUND TË VITIT 2026

F. 7

EKONOMI



SHOQATA E QUMËSHIT, MINISTRISË SË BUJQËSISË: PUBLIKONI PROVAT, JO VETËM PREZANTIMET - KUNDËRSHTOJMË DËNIMIN PUBLIK PA PROVA

F. 8

BOK-JA PUBLIKON RAPORTIN E STABILITETIT FINANCIAR PËR VITIN 2025

F. 8

SPORT



AGIM ADEMI VIZITON FC DRENICËN, DISKUTOHET PËR PËRGATITJET DHE PROJEKTIN E REFLEKTORËVE NË STADIUM

F. 11

TRUMPI PARALAJMËRON IRANIN: NËSE NGUSHTICA E HORMUZIT NUK HAPET SHPEJT, DO TË GODASIM



UASHINGTON, 5 GUSHT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka paralajmëruar Iranin se Uashingtoni do të ndërmarrë veprime të ashpra nëse Ngushtica e Hormuzit nuk rihapet brenda një kohe të shkurtër.

Në një intervistë për "Fox News", Trumpi ka thënë se ShBA-ja "do ta godasë shumë fort" Iranin nëse kjo rrugë strategjike detare nuk hapet "shumë shpejt". Megjithatë, ai theksoi se negociatat me Teheranin po ecin në drejtimin e duhur dhe se pala iraniane është e interesuar

për arritjen e një marrëveshjeje që do t'i japë fund tensioneve të fundit.

Ndërsa sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, ka deklaruar se ka pasur përparim në bisedimet me Iranin dhe Omanin, ndonëse ende nuk është arritur një marrëveshje përfundimtare. Ai është shprehur optimist se një zgjidhje mund të arrihet së shpejti.

Edhe sekretari i Thesarit i ShBA-së, Scott Bessent, ka thënë për "CNBC"-në se një marrëveshje për rihapjen e ngushticës së Hormuzit mund të arrihet "sot ose nesër".

Në përpjekjet diplomatike janë përfshirë edhe Katari, Omani dhe Pakistani, të cilët po ndërmjetësojnë për gjetjen e një zgjidhjeje që do të mundësonte rifillimin e dialogut mes palëve. Ndërkohë, pritshmëritë për një marrëveshje kanë ndikuar në tregjet ndërkombëtare të energjisë. Çmimi i naftës Brent ka shënuar rënie prej 5.26 për qind, duke zbritur në 79.36 dollarë për fuçi, niveli më i ulët që nga 10 korriku, si pasojë e optimizmit për rihapjen e një prej korridoreve më të rëndësishme të transportit të naftës në botë.

MACRONI: BE-ja DO TA RRIKË PRESIONIN NDAJ RUSISË ME SANKSIONE TË REJA

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka deklaruar se Bashkimi Evropian (BE) do të intensifikojë presionin ndaj Rusisë përmes sanksioneve të reja dhe do të forcojë mbështetjen ushtarake për Ukrainën.

Deklarata e Macronit ka ardhur pas sulmeve ajrore ruse në Kiev dhe zonat përreth, të cilat, sipas autoriteteve ukrainase, kanë lënë të vranë 17 persona dhe

dhjetëra të tjerë të plagosur. Në një reagim të publikuar në platformën "X", Macroni ka dënuar sulmet ndaj civilëve, duke i cilësuar ato si pjesë e një "politike terrori" të realizuar përmes raketave dhe dronëve. "Rusia duhet të paguajë çmimin dhe të mbahet përgjegjëse për krimet e saj. Ne nuk do t'i nënshtrohemi lodhjes apo frikësimit dhe do të vazhdojmë të qëndrojmë përkrah Ukrainës", ka shkruar

Macroni.

Ai ka theksuar se BE-ja dhe partnerët e saj do të vazhdojnë të rrisin presionin ndaj Moskës, veçanërisht përmes masave të reja ndëshkuese, ndërsa do të shtojnë ndihmën ushtarake për Ukrainën.

Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelenskyy, ka njoftuar se nga sulmet gjatë natës në Kiev dhe rajonin përreth kanë humbur jetën 17 persona, ndërsa 44 të tjerë janë plagosur.



BE-ja DO TË PËRDORË 1.4 MILIARDË EURO NGA INTERESAT E ASETEVE RUSE PËR UKRAINËN



BRUKSEL, 5 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) do të përdorë 1.4 miliardë euro nga interesat e krijuara mbi asetet e ngrira ruse për të mbështetur Ukrainën, ka bërë të ditur Komisioni Evropian. Fondet burojnë nga interesat mbi bilancet monetare që lidhen me asetet e Bankës Qendrore të Rusisë, të cilat u ngrinin nga BE-ja pas nisjes së pushtimit rus në Ukrainë. Presidentja e Komisionit

Evropian, Ursula von der Leyen, ka deklaruar se këto të ardhura do të përdoren për të ndihmuar Ukrainën në përballimin e pasojave të luftës.

"Rusia duhet të paguajë për shkatërrimin që ka shkaktuar. Ne po përdorim të ardhurat nga asetet e ngrira ruse për të siguruar që kjo të ndodhë", ka thënë von der Leyen.

Sipas saj, fondet shtesë prej 1.4 miliardë eurosh do të

kontribuojnë në forcimin e rezistencës së Ukrainës ndaj agresionit rus dhe në mbështetjen e përpjekjeve të saj gjatë luftës. Vendimi është pjesë e përpjekjeve të BE-së për të shfrytëzuar burimet financiare që lidhen me asetet ruse të ngrira, me synim mbështetjen e Ukrainës dhe kërkimin e përgjegjësisë financiare nga Moska për dëmet e shkaktuara nga konflikti.

Mbi 400 të arrestuar në Francë për zjarret, 14 mijë vatra të raportuara gjatë vitit

Paris, 5 gusht - Autoritetet franceze kanë arrestuar mbi 400 persona që nga nisja e sezonit të zjarreve në vend, ndërsa gjatë vitit 2026 janë raportuar më shumë se 14 mijë vatra zjarri. Ministri i Brendshëm i Francës, Laurent Nunez, ka bërë me dije shifrat e arrestimeve, duke thënë se nga

402 personat e ndaluar, 156 janë të mitur. Autoritetet kanë njoftuar se zjarret në departamentet Gironde dhe Aude janë vënë nën kontroll, ndërsa në departamentin Var vazhdon beteja me flakët.

Nunez ka thënë se zjarri në Var është më i gjati i regjistruar

ndonjëherë në këtë departament, pasi ka vazhduar për 15 ditë rresht. Për shuarjen e tij janë angazhuar 1 250 zjarrfikës, të mbështetur nga dy avionë bombardues uji të tipit "Canadair" dhe dy helikopterë për hedhjen e ujit.

Ndërkohë, autoritetet franceze kanë ulur të martën nivelin e

alarmit për zjarret në Gironde nga i kuq në portokalli, pas përmirësimit të situatës. Studimet e fundit kanë treguar se Evropa po përballet me valë të temperaturave ekstreme dhe zjarre gjithnjë e më shkatërruese, të lidhura me ndryshimet klimatike dhe ndikimin e aktivitetit njerëzor.



SHBA-JA: HUAJA PREJ 302 MILIONË DOLLARËSH FORCON KAPACITETET MBROJTËSE TË SHQIPËRISË

WASHINGTON, 5 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) kanë vlerësuar huanë prej 302 milionë dollarësh për Shqipërinë si një mbështetje për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe rritjen e investimeve në sektorin e mbrojtjes.

Ambasada amerikane në Tiranë ka publikuar njoftimin e Departamentit Amerikan të Shtetit, ku thuhet se financimi, në kuadër të programit të Financimit të Huaj Ushtarak (FMF), do të ndihmojë në modernizimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë përmes blerjes së pajisjeve dhe kapaciteteve me origjinë amerikane.

Sipas Departamentit Amerikan të Shtetit, kjo huadhënie do të kontribuojë edhe në forcimin e aftësisë së Evropës për të udhëhequr mbrojtjen e saj.

Në deklaratë është vlerësuar edhe bashkëpunimi i afërt mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara në fushën e politikës së jashtme dhe sigurisë, duke theksuar rolin e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s.

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë e ka cilësuar

marrëveshjen një moment me rëndësi strategjike dhe një dëshmi të besimit të ShBA-së ndaj Shqipërisë.

Marrëveshja e huasë u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë më 27 korrik, ndërsa sipas saj, fondet do të përdoren ekskluzivisht për modernizimin e Forcave të Armatosura, blerjen e pajisjeve dhe shërbimeve të mbrojtjes në përputhje me standardet e NATO-s. Shqipëria do të ketë 48 muaj për aktivizimin e fondeve dhe 12 vjet për shlyerjen e huasë. Përdorimi i tyre do të monitorohet nga Agjencia Amerikane për Bashkëpunimin në Fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes (DSCA). Marrëveshja u miratua vetëm me votat e shumicës parlamentare, pasi opozita nuk mori pjesë në votim duke kundërshtuar procedurën e ndjekur. Deputetë të Partisë Demokratike e kanë dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se procedura e miratimit ka qenë në kundërshtim me rregullat kushtetuese. Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, e dekretoi ligjin për ratifikimin e marrëveshjes më 30 korrik.



MEDIET NDËRKOMBËTARE RAPORTOJNË PËR GJETJET E FUNDIT TË VARREZAVE MASIVE NË ZUBIN POTOK



PRISHTINË, 5 GUSHT - Zbulimi i lokacioneve të dyshuara për varreza masive në Zubin Potok ka marrë vëmendjen e mediave ndërkombëtare, të cilat po raportojnë për zhvillimet e fundit në hetimet për krimet e luftës në Kosovë.

“Al Jazeera”, duke cituar “AFP”-në dhe “Anadolu”, ka raportuar se autoritetet kosovare kanë identifikuar një lokacion të tretë të mundshëm për varrezë masive, ndërsa hetimet për krimet e luftës të viteve 1998–1999 po vazhdojnë.

“Pas zbulimit të mbetjeve mortore në lokacionin e dytë të hënën, autoritetet thanë të martën se po shqyrtojnë nisjen e gërmimeve në një lokacion të tretë”, shkruan “Al Jazeera”.

Për zhvillimet kanë raportuar

edhe mediat italiane. Agjencia e lajmeve “ANSA”, ka raportuar se të dielën janë gjetur mbetjet mortore të të paktën katër personave, që besohet se janë viktimat e luftës së Kosovës, në lokacionin Jabukë të komunës së Zubin Potokut.

Ndërsa “Euronews Italia” ka theksuar se hetimet janë përqendruar te fati i të ashtuquajturit “grupi i intelektualëve”, i përbërë nga 23 civilë shqiptarë nga Mitrovica.

Sipas rindërtimit të autoriteteve të Kosovës, grupi ishte rrëmbyer më 19 prill 1999, teksa po udhëtonte me autobus drejt Malit të Zi. Burrat ishin nxjerrë me forcë nga autobusi dhe më pas ishin varur.

Komandanti i KFOR-it takon zyrtarin e lartë të Mbrojtjes së Finlandës, diskutojnë për sigurinë në Kosovë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulutash, ka pritur në selinë qendrore të misionit në Kampin “Film City” në Prishtinë gjeneralletjantin

Kari Nisula, zëvendëseshëf i Shtabit për Operacione në Komandën e Mbrojtjes së Finlandës. Sipas njoftimit të KFOR-it, gjatë takimit është diskutuar për situatën e sigurisë në Kosovë, ndërsa

Ulutash ka rikonfirmuar përkushtimin e misionit për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të qetë për të gjithë qytetarët, në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme.

Me këtë rast, komandanti i KFOR-it ka shprehur edhe mirënjohjen për kontributin e vazhdueshëm dhe të rëndësishëm të Finlandës në kuadër të misionit paqeruajtës në Kosovë.





SOT MBAHET SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT, LV-ja DHE LDK-ja SHKOJNË PA MARRËVESHJE PËR INSTITUCIONET E REJA

Sot (e enjte) mbahet seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës, ndërsa partitë politike shkojnë në këtë proces pa një marrëveshje për formimin e institucioneve të reja. Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës nuk kanë arritur pajtim pas takimit treorësh mes Albin Kurtit dhe Lumir Abdixhikut, por kanë paralajmëruar vazhdimin e negociatave. Derisa LDK-ja nuk ka shprehur ambicie për pozitën e kryetarit të Kuvendit, LV-ja pritet ta propozojë serish Albulena Haxhiun për kryeparlamentare

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kuvendi i Kosovës pritet të mbajë sot (e enjte) në orën 10:00 seancën konstituive të legjislaturës së njëmbëdhjetë, ndërsa partitë politike hyjnë në këtë proces pa një marrëveshje për formimin e institucioneve të reja.

Pavarësisht përpjekjeve për arritjen e një dakordimi politik, takimi mes kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje (LV), njëherësh kryeministrit në detyrë, Albin Kurti dhe kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka përfunduar pa marrëveshje konkrete.

Megjithatë, të dy liderët kanë lënë të hapur mundësinë e vazhimit të negociatave, me synimin për të shmangur një

krizë të re institucionale dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme. Takimi mes Kurtit dhe Abdixhikut, i cili ka zgjatur mbi tri orë është zhvilluar dy ditë para seancës konstituive të Kuvendit. "Marrëveshje politike nuk kemi. Diskutoam për qasje të ndryshme dhe mundësitë që kemi përpara. Kemi nevojë për një marrëveshje politike që respekton rezultatin zgjedhor, nuk e zëvendëson atë, por e shndërron në kontribut për stabilitet institucional dhe funksionim të Republikës", është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se koha për arritjen e një marrëveshjeje është e kufizuar dhe se mungesa e një dakordimi mund ta çojë vendin drejt një tjetër cikli zgjedhor.

Nga ana tjetër, Abdixhiku e ka vlerësuar takimin si pozitiv dhe ka deklaruar se LDK-ja

është e gatshme të angazhohet për shmangien e zgjedhjeve të reja.

LV-ja kërkon respektimin e rezultatit zgjedhor, LDK-ja balancë institucionale

Lëvizja Vetëvendosje, si fituese e zgjedhjeve të 7 qershorit është duke synuar që marrëveshja eventuale të bazohet në rezultatin zgjedhor dhe të sigurojë krijimin sa më të shpejtë të institucioneve. LV-ja ka fituar 53 mandate në Kuvend dhe së bashku me deputetët e komuniteteve joshumicë, ka numrat e nevojshëm për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë.

Megjithatë, për zgjedhjen e presidentit nevojitet një shumicë më e gjerë politike,

pasi kërkohet prania e të paktën 80 deputetëve në sallë gjatë votimit.

Në këtë pikë, marrëveshja me LDK-në, e cila ka 18 deputetë, do t'i siguronte shumicës së re parlamentare një numër prej të paktën 81 votash.

LDK-ja, ndërkaq, ka bërë të qartë se nuk synon vetëm një marrëveshje për numra, por kërkon përfshirje në procesin e ndërtimit të institucioneve dhe një balancë politike.

Abdixhiku ka deklaruar se mbështetja e partisë së tij do të varet nga përmbajtja e marrëveshjes. "Nuk mund të diskutoj për mbështetje politike pa pasur substancë. Fillimisht duhet të ndërtohet marrëveshja, pastaj të flasim për numra", është shprehur ai. Ai ka përsëritur se LDK-ja synon një marrëveshje gjithëpërfshirëse, me balancë institucionale dhe përfaqësim të saj në institucionet e reja.

Presidenti, pika kryesore e diskutimeve

Një nga çështjet më të ndjeshme në bisedimet mes dy partive mbetet zgjedhja e presidentit të ardhshëm të Kosovës. Kurti dhe Abdixhiku

kanë me dije se gjatë takimit nuk është diskutuar për emra konkretë për këtë pozitë, por kanë paraqitur qëndrimet e tyre për mënyrën se si duhet të jetë figura e presidentit.

Kurti ka insistuar që presidenti të jetë figurë konsensuale dhe gjithëpërfshirëse. "Jemi të interesuar dhe të gatshëm të bashkëpunojmë me LDK-në. Sa i përket presidentit, qëndrimi ynë është që ai nuk duhet të jetë pjesë e pushtetit politik, por e përfaqësimit të Republikës. Nuk mund të sjell emër konkret, sepse ai duhet të jetë konsensual, gjithëpërfshirës dhe të mos jetë i LV-së", është shprehur ai.

Ndërsa Abdixhiku ka deklaruar se president konsensual konsiderohet ai që siguron 80 vota në Kuvend. "President konsensual është secili president që i merr 80 vota. LDK-ja duhet të ndihet e përfaqësuar për t'i dhënë votat e veta", është shprehur ai.

Mosmarrëveshjet për zgjedhjen e presidentit kanë qenë një nga arsyt që çuan vendin drejt zgjedhjeve të qershorit, të tretat që nga shkurti i vitit 2025.

LDK-ja në zgjedhjet e fundit kishte garuar me ish-presidenten Vjosa Osmani si kandidate për një mandat të ri

ALIU INTERVISTOHET NGA PROKURORIA SPECIALE: KAM VEPRUAR NË PËRPUTHJE ME LIGJIN, NDIHEM I LEHTËSUAR

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ish-ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu është intervistuar nga Prokuroria Speciale nën dyshimet për keqpërdorim të detyrës zyrtare gjatë kohës që ka ushtruar këtë pozitë. Pas intervistimit, Aliu ka deklaruar se ka sqaruar të gjitha çështjet që lidhen me pretendimet ndaj tij, duke theksuar se gjatë ushtrimit të detyrës ka vepruar në përputhje me ligjin.

Aliu ka thënë se pas dy vitesh ka pasur mundësinë të japë versionin e tij dhe se ndihet i lehtësuar pas përfundimit të intervistimit. “Është lehtësim që pas dy vitesh heshtje pata mundësinë të vij dhe ta sqaroj situatën para prokurorisë për gjithë atë pretendim të vazhdueshëm ndaj meje. Gjatë gjithë periudhës sa kam qenë ministër kam vepruar në përputhje me ligjin dhe sipas rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit”, ka



deklaruar Aliu.

Ai ka thënë se nuk ka asnjë vendim që mund të lidhet me të në këtë rast, ndërsa ka shtuar se çështja ka qenë objekt i auditimit dhe hetimeve të brendshme.

“Për pretendimin për mosveprim, i tërë rasti ka qenë i audituar nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe janë dhënë rekomandime, mbi bazën e të cilave është vepruar”, ka thënë ai.

Ndërsa avokati i tij, Artan Qerkini, ka deklaruar se Aliu i është përgjigjur ftesës së Prokurorisë pa hezitim dhe ka dhënë të gjitha sqarimet e kërkuara në cilësinë e personit të dyshuar. “Zoti Aliu i është përgjigjur ftesës së prokurorisë pa asnjë hezitim. Ka dhënë të gjitha shpjegimet për funksionin e tij si ministër dhe përgjegjësitë që ka pasur në lidhje me pretendimet e prokurorisë”, ka deklaruar Qerkini.

HARADINAJ: OPOZITA DUHET TA KETË PRESIDENTIN OSE KRYEMINISTRIN



PRISHTINË, 5 GUSHT - Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka deklaruar se partitë opozitare mund ta ndihmojnë vendin vetëm nëse përfshihen në procese të rëndësishme vendimmarrëse, e jo vetëm duke marrë pjesë në qeverisje. Sipas tij, në një koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje, opozita duhet të ketë rol të barabartë në përcaktimin e politikave dhe një nga pozitat kryesore shtetërore.

Haradinaj ka thënë se një parti nuk duhet të marrë pjesë në qeveri pa pasur ndikim real në vendimmarrje, duke theksuar se rezultati i zgjedhjeve duhet të interpretohet si nevojë për bashkëvendimmarrje. “Kurti po dëshiron me e poshtëruar opozitën duke i ofruar vetëm pjesëmarrje në qeverisje.

Udhëheqësit e regjimit totalitar frikësohen nga bashkëvendimmarrja. Opozita s’duhet që vetëm të marrë pjesë në qeverisje”, ka deklaruar Haradinaj.

Ai ka shtuar se nëse kryetari i LVV-së, Albin Kurti, e lexon rezultatin zgjedhor si kërkesë për bashkëpunim politik, atëherë duhet të ketë marrëveshje reale mes palëve. “Nuk mendoj që opozita e ndihmon Kosovën duke u bërë pjesë e qeverisë vetëm për përfitime të pushtetit. Opozita e ndihmon Kosovën vetëm nëse bëhet pjesë e vendimmarrjes”, ka thënë Haradinaj.

Sipas tij, për të garantuar një balancë politike, opozita duhet ta ketë njërën prej dy pozitave kryesore në shtet - postin e presidentit ose atë të kryeministrit.

në krye të shtetit.

LDK-ja nuk kërkon postin e kryetarit të Kuvendit

Pavarësisht mungesës së një marrëveshjeje, Abdixhiku ka bërë me dije se LDK-ja nuk ka interes për postin e kryetarit të Kuvendit. “Nëse nuk ndodh asgjë, kemi kërkuar që të vazhdohet me konstituimin e Kuvendit. LDK-ja nuk ka interes për postin e kryetarit të Kuvendit”, është shprehur ai.

Sipas Kushtetutës, partisë fituese i takon e drejta për të propozuar kandidatin për kryetar të Kuvendit. Sipas të gjitha gjasave, LV-ja pritet të propozojë Albulena Haxhiun për këtë pozitë.

Pas konstituimit të Kuvendit, fillojnë afatet kushtetuese për formimin e qeverisë dhe zgjedhjen e presidentit. Sipas një aktvendimi të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi ka 60 ditë kohë për ta zgjedhur presidentin e ri. Në rast të dështimit, vendi shkon

në zgjedhje të reja.

Kurti kërkoj takime edhe me PDK-në dhe AAK-në

Para takimit me Abdixhikun, Kurti ka zhvilluar përpjekje për takime edhe me partitë e tjera parlamentare. Ai ka ftuar në takim kryetarin e PDK-së, Bedri Hamza, dhe kryetarin e AAK-së, Ardian Gjini, por që të dy kanë refuzuar.

Pas takimit me Abdixhikun, Kurti ka theksuar se liderët politikë duhet të komunikojnë

dhe të bashkëpunojnë. “Duhet të takohemi, të komunikojmë dhe të bashkëpunojmë”, është shprehur Kurti.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, pas takimit të mëhershëm me Kurtin ka deklaruar se partia e tij do të mbetet në opozitë.

Kurse kryetari i AAK-së, Ardian Gjini, ka refuzuar takimet me Kurtin, duke paraqitur disa kërkesa në këmbim të mbështetjes për krijimin e institucioneve.

AAK-ja ka bërë me dije se nuk

është e interesuar të jetë pjesë e qeverisë, por ka ofruar mundësinë e mbështetjes për themelimin e institucioneve nëse plotësohen disa kërkesa politike. Me fillimin e punës së Kuvendit dhe vazhdimin e bisedimeve ndërpartiake, mbetet e hapur mundësia për një marrëveshje mes LV-së dhe LDK-së, por edhe skenari i zgjedhjeve të reja nëse palët nuk arrijnë kompromis.

Një ditë para mbajtjes së seancës, kryetari i LDK-së është takuar me deputetët e grupit

Oficeri i FSK-së, Krenar Lahu, diplomon në një nga akademitë më prestigjioze ushtarake në botë

PRISHTINË, 5 GUSHT - Major Krenar Lahu, oficer i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), ka diplomuar me sukses në Kursin e Komandës dhe Shtabit në Akademinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, një prej institucioneve më prestigjioze të arsimit ushtarak profesional në botë.

Programi zhvillohet në kuadër të Joint Services Command and

Staff College dhe përgatit oficerët për detyra të nivelit të lartë komandues dhe të shtabit. Gjatë këtij kursi, pjesëmarrësit trajnohen në fusha si planifikimi operacional, udhëheqja, strategjia, vendimmarrja dhe bashkëpunimi shumëkombësh. Diplomimi i majorit Lahu vlerësohet si një arritje e rëndësishme profesionale dhe dëshmi e angazhimit të

vazhdueshëm të FSK-së për ngritjen e kapaciteteve të personelit përmes programeve prestigjioze ndërkombëtare të edukimit ushtarak.

Ky sukses kontribuon gjithashtu në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar në fushën e mbrojtjes dhe zhvillimit profesional të kuadrove ushtarake.



KOMUNA E PODUJEVËS SHPALL GJENDJE EMERGJENTE PËR SHKAK TË MBETURINAVE



PODUJEVË, 5 GUSHT - Shtabi Emergjent për Mbrojtje dhe Shpëtim i Komunës së Podujevës ka shpallur gjendje emergjente për shkak të situatës së rënduar me mbeturinat. Sipas njoftimit të komunës, kjo gjendje është shkaktuar nga mosbartja e mbeturinave nga operatorët përgjegjës. Gjendja emergjente do të jetë në fuqi nga 5 gushti

deri më 5 nëntor 2026.

Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka deklaruar se menaxhimi me mbeturinat në qytet dhe fshatra është rënduar gjatë muajve të fundit.

Sipas tij, Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi", për shkak të pamundësisë për të ofruar shërbime në disa zona, kishte kërkuar më herët lirin

nga përgjegjësia për shërbimin në fshatra, i cili më pas i është kaluar kompanisë private "Natyra".

Bulliçi ka thënë se tashmë probleme ka edhe në qytet, ku sipas tij ka raste kur kompania operon vetëm me një kamion ose nuk ofron shërbim fare. "Për shkak të kësaj gjendjeje që është krijuar, ku tash i kemi edhe mërgimtarët këtu dhe

vëllimi i mbeturinave është rritur, duke pasur parasysh shëndetin e qytetarëve, kam marrë një rekomandim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të shpallim gjendjen emergjente", ka deklaruar Bulliçi.

Propozimi për shpalljen e gjendjes emergjente është miratuar njëzëri. Me vendimin e kryetarit të komunës,

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit është obliguar të hartojë dhe zbatojë planin operacional emergjent për grumbullimin, transportimin dhe largimin e mbeturinave, si dhe të iniciojë procedurën e përsheptuar të prokurimit për sigurimin me qira të tre kamionëve dhe tre vozitësve, të cilët do të operojnë në kuadër të KRM "Pastrimi".

Prishtina hap konkurs ndërkombëtar për projektimin e varrezave, Rama: Janë pasqyrë e dinjitetit të qytetit

Prishtinë, 5 gusht - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar hapjen e konkursit ndërkombëtar për projektimin e varrezave të kryeqytetit. Rama ka thënë se edhe varrezat e kryeqytetit janë pasqyrë e dinjitetit të një qyteti dhe e respektit që ai

tregon për secilin qytetar. "Konkurs ndërkombëtar për projektimin e varrezave të kryeqytetit Prishtina. Varrezat e Kryeqytetit janë pasqyrë e dinjitetit të një qyteti dhe e respektit që ai tregon për secilin qytetar. Prandaj, Kryeqyteti ka iniciuar

projektin për zgjerimin dhe riorganizimin e Varrezave të Kryeqytetit, një projekt që siguron hapësirë dinjitoze për të gjithë qytetarët, duke respektuar të gjitha besimet fetare dhe nevojat e secilit komunitet", ka njoftuar Rama.



Pesë zyrtarë të Listës Serbe ftohen në Prokurori, dyshohen për falsifikim të dokumenteve komunale

PRISHTINË, 5 GUSHT - Pesë zyrtarë të Listës Serbe, Igor Simiq, Ivan Zaporosaq, Ivan Todosijeviq, Zoran Todiq dhe Vasilije Tomaseviq janë ftuar nga Prokuroria Themelore në Mitrovicën e Veriut për të dhënë deklarata më 13 gusht, në cilësinë e të pandehurve. Lajmin e ka bërë të ditur Lista Serbe, e cila ka pretenduar se procedura lidhet me zhvillimet pas ndërhyrjes së

Policisë së Kosovës në institucionet që funksiononin sipas sistemit të Serbisë në veri të Kosovës. Sipas kësaj partie, zyrtarët dyshohen për falsifikim të dokumenteve komunale, ndërsa ka pretenduar se ndjekja penale ndaj tyre lidhet me funksionet që kanë ushtruar në institucionet e sistemit serb. “Kjo është pjesë e një plani më të gjerë që

synon persekutimin e popullit serb dhe vazhdimin e presionit institucional mbi të gjithë ata që qëndrojnë pranë popullit të tyre dhe mbrojnë të drejtën e tyre për mbijetesë”, ka deklaruar Lista Serbe. Procedura lidhet me zhvillimet pas nëntorit të vitit 2022, kur përfaqësuesit serbë, të udhëhequr nga Lista Serbe, u larguan nga institucionet e Kosovës, përfshirë policinë,



gjyqësorin, komunat, Qeverinë dhe Kuvendin, pas krizës së targave dhe kërkesës për formimin e Asociacionit të

Komunave me Shumicë Serbe. Autoritetet e Kosovës më pas kanë marrë nën administrim ose kanë mbyllur disa institucione që funksiononin sipas sistemit të Serbisë në veri të vendit. Ky nuk është rasti i parë që autoritetet e drejtësisë në Kosovë zhvillojnë procedura ndaj ish-zyrtarëve të institucioneve që kanë vepruar në kuadër të sistemit serb.

BËRI DEKLARIM TË RREMË PËR KRIMET NË ZUBIN POTOK, NJË PERSON NDALOHET PËR 48 ORË

PRISHTINË, 5 GUSHT - Një burrë nga fshati Zupç i komunës së Zubin Potokut është ndaluar deri në 48 orë, pasi dyshohet se ka dhënë deklaram të rremë gjatë një hetimi për krime lufte. Sipas avokatit të tij, Millosh Deleviq, D.V. ishte ndaluar më herët gjatë ditës në pikëkalimin kufitar në Bërnjak dhe ishte dërguar për të dëshmuar në cilësinë e dëshmitarit në hetimin që Prokuroria Speciale e Kosovës po zhvillon për krime lufte në Zubin Potok. “Ai u dërgua në Bërnjak për të dhënë dëshminë si dëshmitar në hetimin për

krime lufte. Më pas, prokurori vendosi të nisë procedurë ndaj tij nën dyshimin për dhënie të deklaramit të rremë, për çka iu caktua ndalimi policor deri në 48 orë”, ka deklaruar avokati për mediumin lokal “Zubin Potok INFO”. Sipas Deleviqit, D.V. ishte ndaluar rreth orës 13:00 në pikëkalimin mes Kosovës dhe Serbisë. Edhe Policia e Kosovës ka njoftuar se të martën, rreth orës 14:30, në Mitrovicën e Veriut është arrestuar një i dyshuar, pasi kishte dhënë deklaram të rremë gjatë intervistimit nga njësia



policore. Në njoftimin e policisë është thënë se me vendim të prokurorit, i dyshuari është dërguar në

mbajtje, por nuk specifikohet nëse bëhet fjalë për personin me inicialet D.V. Prokuroria Speciale e Kosovës është duke zhvilluar hetime për krime lufte në komunën e Zubin Potokut, ku po kryhen gërmime në disa lokacione, për të cilat autoritetet dyshojnë se mund të ketë mbetje mortore të shqiptarëve, kryesisht nga rajoni i Mitrovicës, të cilët rezultojnë të zhdukur që nga lufta e vitit 1999. Lidhur me këtë rast, deri më tani janë arrestuar tre persona në Zubin Potok, ndaj të cilëve është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji.

KGJK-ja NESËR SHQYRTON DORËHEQJET E GJYQITARËVE DHE STAFIT SERB

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) ka caktuar mbledhjen e radhës për nesër (e premte), ku në të cilën në rend dite është edhe shqyrtimi i kërkesës së ushtrueses së detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, dhe i njoftimeve të gjyqtarëve dhe stafit nga komuniteti serb për tërheqjen e dorëheqjeve. Në rend dite janë gjithsej 16 pika, ndërsa shqyrtimi i tërheqjes së dorëheqjeve është në pikën e nëntë, raporton “Betimi për Drejtësi”. Në mbledhjen e kaluar, më 24 korrik, kishte dështuar të trajtohej kjo pikë e rendit të



ditës, pasi mbledhja dështoi për shkak të mungesës së kuorumit. Kujtojmë se ushtruesja e detyrës së Presidentes, Albulena Haxhiu, përmes një letre të dërguar më 19 qershor 2026 te kryesuesi i KGJK-së, Rustem Thaqi, kishte kërkuar

që Këshilli t’i japë epilog çështjes së dorëheqjeve të ofruara nga gjyqtarët dhe stafi mbështetës i komunitetit serb brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. “Mbajtja pezull e këtyre pozitave për një periudhë kaq të gjatë cenon sigurinë juridike, pengon funksionimin e plotë të sistemit të drejtësisë dhe ndikon në efikasitetin e institucioneve përgjegjëse”, është thënë ndër të tjera në letër. Në anën tjetër, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në takimin e mbajtur më 20 korrik 2026, ka refuzuar tërheqjen e

dorëheqjeve të prokurorëve dhe stafit mbështetës serb brenda sistemit prokurorial, duke ia dërguar kërkesën ushtrueses së detyrës së presidentes për lirimin nga detyra. Haxhiu, një ditë më pas (21 korrik), njoftoi se ka nënshkruar dekretet për lirimin nga detyra të shtatë prokurorëve serbë, të cilët kishin ofruar dorëheqjet më 2022. Për vendimin e KPK-së dhe Haxhiut, Bashkimi Evropian ka vlerësuar se janë në kundërshtim me ligjin. “BE-ja është e shqetësuar nga

vendimi i djeshëm i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) për të pranuar dorëheqjet që ishin tërhequr tashmë dhe nga vendimi i sotëm i ushtrueses së detyrës së Presidentes, që dekretoi dorëheqjet. Kjo duket se nuk është në përputhje me ligjin, me procedurën e rregullt ligjore dhe me kërkesat e përgjithshme të sundimit të ligjit në Kosovë. BE-ja u bën thirrje të gjitha institucioneve përkatëse që të përmbahen nga veprimet që synojnë pengimin e riintegritimit të personelit gjyqësor serb të Kosovës”, është thënë në reagimin e BE-së.

Kusari-Lila mirëpret 15 inspektorë të rinj: Synojmë t’i rrisim në 100 deri në fund të vitit 2026

PRISHTINË, 5 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila, ka mirëpritur 15 inspektorë të rinj të transferuar nga niveli lokal në kuadër të zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut. Ajo e ka cilësuar këtë si një hap të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe në zbatimin e reformave në këtë sektor. Sipas Kusari-Lilës, me

transferimin e inspektorëve të rinj, numri i përgjithshëm i inspektorëve në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut ka arritur në 39. “Me këtë transferim, numri i përgjithshëm i inspektorëve të IQMT-së arrin në 39, përkatësisht 24 inspektorë aktualë dhe 15 inspektorë të rinj. Deri në fund të vitit 2026 synojmë që ky numër të rritet në 100 inspektorë, duke dyfishuar kapacitetet tona mbikëqyrëse në

të gjithë territorin e Republikës së Kosovës”, ka deklaruar ministria Kusari-Lila. Ajo ka theksuar se rritja e numrit të inspektorëve do të ndikojë në mbrojtjen e konsumatorëve, garantimin e sigurisë së produkteve dhe zbatimin më efikas të legjislacionit në treg. Sipas saj, zgjerimi i kapaciteteve do të kontribuojë në krijimin e një tregu më të drejtë, më të sigurt dhe më të besueshëm për qytetarët e Kosovës.



SHOQATA E QUMËSHTIT, MINISTRISË SË BUJQËSISË: PUBLIKONI PROVAT, JO VETËM PREZANTIMET - KUNDËRSHTOJMË DËNIMIN PUBLIK PA PROVA

PRISHTINË, 5 GUSHT - Shoqata e Industrisë së Qumështit të Kosovës (ShIQK), e cila përfaqëson kompanitë “Drena”, “Aldi”, “Bylmeti”, “Golaj ShPK”, “Bio Sharri Progress”, “Kabi”, “Magic Ice”, “Qaushi”, “Rugove”, “Sharri” - Prizren, “Abi”, “Vita”, “Jeti”, “Koral” dhe “Sharri” - Kuk, ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me mënyrën se si Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës (AUV) i kanë prezantuar rezultatet e kontrolleve në sektorin e qumështit. Kjo shoqatë ka thënë se mbështet plotësisht kontrollin institucional, sigurinë ushqimore dhe marrjen e masave

ndaj çdo operatori që ka shkelur ligjin, por ka theksuar se asnjë kompani dhe asnjë sektor nuk mund të dënohet publikisht pa u publikuar analizat origjinale, dokumentacioni përkatës dhe provat e verifikueshme. “Gjatë konferencës u deklarua se janë marrë 495 mostra, janë analizuar 471 prej tyre dhe janë identifikuar 93 mospërputhje. Por publikut nuk iu prezantuan raportet e plotë laboratorike, etiketat origjinale të produkteve, numrat e loteve, datat e mostrimit, procesverbalet dhe metodat laboratorike të përdorura”, është thënë në reag-



imin e ShIQK-së. Nga shoqata është kërkuar publikimi i emrit të produktit, prodhuesit ose importuesit, numrit të lotit, fotografisë dhe kopjes së etiketës origjinale, datës, vendit dhe procesverbalit të marrjes së mostrës, metodës laboratorike dhe statusit të akreditimit, si dhe listës së plotë të 93 mospërputhjeve.

Po ashtu, është kërkuar sqarim për dallimin ndërmjet 495 mostrave të marra dhe 471 mostrave të analizuara. Ndryshe, anëtarët e kësaj shoqate grumbullojnë së bashku mbi 300 mijë litra qumësht në ditë, duke përfaqësuar pjesën dërrmuese të përpunimit të qumështit vendor dhe mijëra fermerë në mbarë Kosovën. “Njëkohësisht, vërejmë se në diskutimet publike dhe institucionale është përfshirë edhe organizata e quajtur Shoqata e Qumështorëve të Kosovës, e cila, sipas informacioneve që disponojmë, përfaqësohet nga kompania ‘Ajka’ përmes

Ramadan Memës. Sipas të dhënave tona, kjo kompani grumbullon rreth 1 mijë litra qumësht në ditë dhe, për këtë arsye, vlerësojmë se kjo organizatë nuk mund të konsiderohet përfaqësuese e industrisë së qumështit në Kosovë”, është thënë në reagimin e ShIQK-së. Shoqata u ka bërë thirrje institucioneve që në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes të mbështeten te organizatat që përfaqësojnë realisht sektorin, bazuar në anëtarësinë, kapacitetin prodhues dhe peshën e tyre në treg, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë operatorët.

BQK-ja PUBLIKON RAPORTIN E STABILITETIT FINANCIAR PËR VITIN 2025

PRISHTINË, 5 GUSHT - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka publikuar Raportin e Stabilitetit Financiar për vitin 2025, i cili paraqet vlerësimin e zhvillimeve në sistemin financiar, rreziqeve ndaj stabilitetit financiar dhe qëndrueshmërisë së sistemit financiar përballë zhvillimeve të pafavorshme, duke evidentuar kapacitetin e tij për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit. Raporti është hartuar në një periudhë të karakterizuar nga pasiguri të larta, tensione gjeopolitike, presione inflacioniste dhe kushte më të shtrënguara të financimit. Përkundër këtyre zhvillimeve, ekonomia e Kosovës ka vazhduar të shënojë rritje pozitive gjatë vitit 2025, ndërsa aktiviteti ekonomik është përsheptuar në tremujorin e parë të vitit 2026. Pozicioni i shëndoshë fiskal, niveli i ulët i borxhit publik dhe ruajtja e disiplinës fiskale kanë vazhduar të kontribuojnë në zbutjen e



rreziqeve makroekonomike. Raporti ka konfirmuar se sistemi financiar i Kosovës ka ruajtur stabilitet të lartë gjatë vitit 2025, duke dëshmuar qëndrueshmëri ndaj zhvillimeve në ekonomi. Pozita e shëndoshë financiare e institucioneve financiare, korniza e avancuar rregullative dhe mbikëqyrëse, si dhe politikat makroprudenciale të ndjekura nga BQK-ja, kanë forcuar më tej kapacitetin e sistemit financiar për të absorbuar rreziqet dhe për të ruajtur funksionimin e qëndrueshëm të ndërmjetësimit financiar. Vlerësimi i përgjithshëm i raportit është se rreziqet ndaj stabilitetit financiar mbeten nën kontroll. Sistemi financiar

vazhdon të karakterizohet nga pozicioni i fortë kapitali, likuiditeti i mjaftueshëm, cilësi e mirë e aseteve dhe burime të qëndrueshme financimi, duke ruajtur aftësinë për të mbështetur ekonominë edhe në rast të materializimit të skenarëve më pak të favorshëm. Kjo dëshmon se sistemi financiar vazhdon të kryejë në mënyrë efektive funksionet e tij kryesore, duke ruajtur besimin e publikut dhe duke mbështetur financimin e ekonomisë. Raporti ka vlerësuar se, megjithëse mjedisi ndërkombëtar vazhdon të karakterizohet nga pasiguri të lidhura me tensionet gjeopolitike, fragmentimin ekonomik, kushtet më të shtrënguara financiare, inflacionin dhe rritjen e rreziqeve kibernetike, sistemi financiar i Kosovës ka dëshmuar kapacitete të mjaftueshme për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të absorbuar goditje të mundshme. Një nga gjetjet kryesore të raportit është se rezervat ekzistuese të kapitalit dhe

likuiditetit, së bashku me kapacitetin për gjenerimin e të ardhurave, sigurojnë vazhdimësinë e funksionimit të sektorit financiar dhe aftësinë e tij për të vazhduar mbështetjen e aktivitetit ekonomik edhe në kushte më sfiduese. Gjithashtu, rezultatet e stres-testimeve kanë konfirmuar se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm edhe nën skenarë të rënduar makroekonomikë dhe financiarë. Raporti ka theksuar gjithashtu rëndësinë e politikës makroprudenciale të BQK-së, e cila synon identifikimin në kohë të rreziqeve sistematike dhe forcimin e rezervave mbrojtëse të sektorit financiar. Kjo qasje kontribuon në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe krijon parakushte për zhvillimin e qëndrueshëm të ndërmjetësimit financiar. Njëkohësisht, raporti ka evidentuar progresin e vazhdueshëm në forcimin e qëndrueshmërisë operacionale dhe kibernetike, modernizimin e infrastrukturës financiare dhe avancimin e digjitalizimit të shërbimeve financiare. Këto

zhvillime rrisin sigurinë, efikasitetin dhe besimin në sistemin financiar, duke forcuar aftësinë e tij për t’iu përshtatur rreziqeve dhe sfidave në zhvillim. Megjithë zhvillimet pozitive, raporti paraqet perspektivën dhe ekspozimin ndaj pasigurive nga mjedisi i jashtëm, përfshirë tensionet gjeopolitike dhe luhatjet në tregjet ndërkombëtare të energjisë, të cilat kërkojnë vëmendjen e duhur institucionale. Në përfundim, me mandatin e saj ligjor, BQK-ja do të vazhdojë të zbatojë politikën e kujdesshme mbikëqyrëse dhe makroprudenciale, në harmoni me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të identifikojë me kohë rreziqet potenciale dhe të ndërmarrë masat e nevojshme për ruajtjen e stabilitetit financiar. Gjithashtu, BQK-ja synon të forcojë më tej qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe të krijojë kushte të favorshme për rritje ekonomike të qëndrueshme.

Kurti merr pjesë në përrurimin e rehabilitimit të kanalit të Ibër-Lepencit në Zubin Potok

ZUBIN POTOK, 5 GUSHT - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në përrurimin e përfundimit të projektit të rehabilitimit të kanalit kryesor të Ibër-Lepencit, “Siguria ujore dhe mbrojtja e kanalit”, në Zubin Potok. Gjatë ceremonisë, Kurti ka theksuar rëndësinë strategjike të këtij projekti, i cili sipas tij rrit sigurinë e infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe energji.

“Përmes këtij projekti, në vlerë prej 18 milionë eurosh, janë rehabilituar 37 segmente kyçe përgjatë 49 kilometrave të kanalit, si dhe është ndërtuar një rezervuar kompensues me kapacitet prej 30 mijë metra kub, i cili mundëson furnizim emergjent për termocentralet ose ujësjellësit në raste nevojë”, ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se mbrojtja e kanalit të Ibër-Lepencit nuk është vetëm çështje lokale apo teknike, por ka rëndësi për funksionimin e përditshëm të

vendit. “Ky është mbrojtje e jetës së përditshme të Republikës, e dritës në shtëpitë tona, e ujit nga rubineti, e prodhimit të ekonomitë dhe e bukës nga ara”, është shprehur Kurti. Sipas tij, përfundimi i këtij projekti dëshmon se Kosova nuk fokusohet vetëm në reagimin ndaj rreziqeve, por në ndërtimin e kapaciteteve që mundësojnë parandalimin e tyre dhe vazhdimësinë e shërbimeve esenciale për qytetarët.



NË BINÇË ËSHTË RUAJTUR PALCA ORIGJINALE E KOMBIT SHQIPTAR



Ismet SYLEJMANI

Shumë i dashur dhe i nderuar Dom Frok Zef Sopi, Famullitar i Kishës Shqiptare Katolike të Binçës e të Vitisë!

I nderuat Dom Lush Gjergji, teë nderuar priftërinj e motra të nderit!

Të nderuara familje të Heronjëve dhe Dëshmoreve të Kombit, invalid e veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

I nderuar Shok e bashkëluftëtar, Anëtar i Shtabit e Shef i G-2-shit të Shërbimit Informativ të Zonës Operative të Karadakut të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Abdyl Bajrami!

Shumë e dashura Nëna shqiptare katolike Stane Pjetër Gashi, Nëna e bukës së luftës së armatosur për liri e njëra prej Nënave më të medha të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, faleminderit që je në mesin tonë!

I nderuar Kryetar i Komunës së Vitisë Sokol Haliti!

Të nderuar profesor Jahja Drançolli e Anton Nik Berisha!

Të nderuar drejtues shtetëror, lokal e qendror!

*Të nderuar të pranishëm!
Zonja dhe zotrinjë!*

Jam shumë i nderuar për ftesën që më është bërë nga Miku e Vëllau im Dom Frok Zef Sopi, për të mbajtur një fjalë rasti në këtë Simpozium historik, sot këtu në qytetin e Vitisë!

Kjo është paraqitja ime e dytë përpara jush, pas asaj të parës para popullit shqiptar të Vitisë, para njësiteve të ushtarëve të Brigadës "Gursel e Bajram Sylejmani", kur në cilësinë e Zëdhënësit të luftës, jamë ndarë për herë të fundit në emër të Komandës së Shtabit të Zonës Operative të Karadakut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në



rivarrimin e Heronjve dhe Dëshmoreve të Kombit më 27 Gusht të vitit 1999, të cilët jo shumë larg nga këtu, prehen e ndriqojnë përgjithmonë në Kosovën e çliruar, të lirë e të pavarur nga Serbia pushtuese!

Vëllezër e motra,

Binça e truallit të Arbërit, Binça e lashtë e vitit të largët 1019, Binça fshati origjinal shqiptar, e cila ishte dhe mbetet fanar që ndriçon të ardhmen e ndritur dhe euroatlantike të popullit, Atdheut dhe Kombit tonë, na ka bashkuar sot e do të na mbajë të bashkuar gjithmonë

në shekuj e mijëvjeçar!

Rajoni i Binçës, i Stubllës, i Letnicës dhe i tërë Malësisë së panënshtuar të Karadakut me Shkupin, Kumanovën, Luginën e Preshevës, Anamoravën dhe me Kryeqytetin e kryengritjes dhe arenen e madhe të luftës antiosmane Kaçanikun heroik, përbëjnë një nga hapësirat më të rëndësishme historike e kulturore të popullit shqiptar të Kosovës, ku rrënjët e identitetit shqiptar janë ruajtur ndër shekuj, pavarësisht pushtimeve, pavarësisht trysnive politike dhe

përpjekjeve të tmerrshme për asimilim e shkombëtarizim!

Binça në veçanti, bashkë me Stubllën dhe fshatra të boshatisura të tjera të atij rrethi në përgjithësi, historia dëshmon se ishin vatra të mëdha të qëndresës heroike kombëtare!

Ai teritor nuk është vetëm një hapësirë gjeografike në hartën e Atdheut tonë të dashur e të shtrenjtë, por është një nga epiqendrat e qëndresës dhe e kryengritjeve e luftërave heroike kundër hordhive pushtuese të Perandorisë Osmane!

Është një trevë legjendare ku





gjuha shqipe, traditat, zakonet, dashuria e pastër dhe ndjenja e lirë kombëtare origjinale shqiptare, janë trashëguar e janë ruajtur nga brezi në brez!

Shqiptarët e kësaj ane, shqiptarët katolikë, ruajtën ndër shekuj vetëdijen e përkatësisë së tyre kombëtare dhe i përballuan të gjitha format e asimilimit, ndonëse i paguan shumë shtrenjtë, por ia arritën, dolën triumfatorë dhe sot i janë kthyer me tërë qenien e tyre trungut të Arbërisë ilire dhe rezatojnë perspektivë të madhe euroamerikane e të ndritur për kombin tonë!

Binça, sikur edhe Stublla e Kabashi, por edhe pjesë të

tjera të popullatës katolike shqiptare, me heroizëm biblik mbrojtën dhe mësuan gjuhën shqipe, kulturën dhe zakonet shqiptare edhe në periudhat më të vështira e më të rënda, atëherë kur shpata pushtuese priste dhe grinte koka atdhetarësh e prifëtrinjt patriot kombëtar!

Roli i Kishës Katolike Shqiptare në këtë trevë ishte rol brilant e crucial në ruajtjen e arsimit, traditës dhe identitetit kombëtar!

Binça, ky fshat i lashtë shqiptar dhe fshatrat e tjerë përreth, ishin pjesë e pandashme e qëndresës së pathyeshme antipushtuese osmane, i dhanë gjak e luftëtarë lirie Atdheut, sikur

janë të pavdekshmit Martirët e Karadakut!

Banorët e Binçës dhe të atij pellgu u përballën me regjime të ndryshme, por nuk hoqën dorë nga gjuha shqipe, nga trashëgimia kulturore dhe nga ideali i lirisë kombëtare!

Në periudha të ndryshme të luftërave për liri e çlirim të Kosovës nga pushtues të ndryshëm antishqiptar, kjo trevë me Binçën kryeqendër lashtësie ilire dha kontribut të çmuar në përpjekjet për çlirimin e vendit nga zgjedha e robërisë!

Shumë bij e bija të Karadakut liridashës u rreshtuan në luftën për liri, ndërsa popullata mbështeti pa rezervë përpjekjet dhe

aktivitetet e tyre kombëtare!

Sot, Binça bashkë me fshatrat e tjera shqiptare është me ndikim në historinë kombëtare, dhe dëshmojnë se identiteti original shqiptar nuk është ruajtur vetëm me armë dhe luftëra të armatosura çlirimtare, por edhe me shkollën, me fenë origjinale shqiptare, me kulturën, me gjuhën shqipe dhe me memorien historike!

Krahina lavdimadhe e Karadakut, në të cilën Binça e lashtë mijëvjeçare, zë vend nderi, dëshmon se kombi shqiptar ka ditur të mbijetojë jo vetëm duke luftuar, por edhe duke ruajtur me përkushtim rrënjët e veta të së kaluarës së pastër origjinale e

tipike shqiptare!

Binça bën pjesë ndër ato vende ku fryma shqiptare jo vetëm nuk u shua kurrë, por edhe vazhdon të jetojë me dinjitet, me nderë e me krenari edhe sot!

Shumë të dashur motra e vëllezër shqiptar katolik,

Faleminderit që e keni ruajtur fenë e të parëve, dhe na keni renditur përkrah popujve euroatlantik, me kontribute të mëdha në arenën botërore, që nga Gjergj Kastrioti Skenderbeu e deri te e famshmja Nëna shqiptare e planetit njerëzor, Nënë Tereza!

Faleminderit!
Viti, 3 Gusht 2026!

SIMPOZIUMI

03 gusht 2026, ora 18:00

Teatri i qytetit në Viti

Ligjërues:

- Sokol Haliti – Nga Kalaja e Binçës deri te Gryka e Moravës
- Jahja Drançolli – Binça në historinë njëmijëvjeçare të besimit të krishterë
- Anton Nikë Berisha – Binça njëmijëvjeçare në rrafshin kulturor dhe letrar
- Ismet Sylejmani – Binça – dëshmi e identitetit arbëror shqiptar
- Frok Zefi Sopë – Binça dhe, sot dhe nesër

1019 Kartë – Krisobulë e Perandorit Bizantin Basil II

1258 Kartë – Krisobulë e Mbretit Bullgar Konstantin Asen-it, Binça përmendet në vitin 1258, me emër Binçe (Binçekes) ku cekët se kishte tri kisha dhe rreth 500 banorë me një ekonomi të zhvilluar mirë.

3 kisha me 500 banorë ekonomitë e zhvilluar mirë

Organizator: Familja e Binçës, në bashkëpunim me Komunën e Vitisë.

SIMPOZIUMI


KALAJA E BINÇES

HISTORI • TRASHËGIMI • SHQIPËRI

Fshati Binçe si vendbanim përmendet zyrtarisht në vitin 1019 në Kartën – Krisobulë ("Krisobulë") – akt dhurate, document zyrtar historik) të Perandorit Bizantin BAZILIT II.

Kurse, në Kartën "Krisobulë" – akt dhurate e mbretit bullgar Konstantin Asen-it, Binça përmendet në vitin 1258, me emër Binçe (Binçekes) ku cekët se kishte tri kisha dhe rreth 500 banorë me një ekonomi të zhvilluar mirë.

1000 vjet histori • 1000 vjet Binçe • Jemi këtu dhe do të mbetemi!



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Agim Ademi viziton FC Drenicën, diskutohet për përgatitjet dhe projektin e reflektorëve në stadium

SKENDERAJ, 5 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka vizituar ambientet e FC Drenicës, ku është pritur nga drejtuesit e klubit.

Gjatë takimit, përfaqësuesit e FC Drenicës e kanë informuar

kryetarin e FFK-së për ecurinë e klubit dhe përgatitjet që po bëhen për sezonin e ri garues.

Një nga temat kryesore të diskutimit ishte edhe projekti për vendosjen e reflektorëve në stadiumin e Drenicës, i cili po financohet nga Federata e

Futbollit të Kosovës. Sipas klubit, punimet për këtë projekt po zhvillohen sipas planit.

Agim Ademi ka rikonfirmuar përkushtimin dhe angazhimin e FFK-së për krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e

futbollit në vend. FC Drenica ka shprehur mirënjohje për përkrahjen e vazhdueshme të Federatës së Futbollit të Kosovës, duke vlerësuar kontributin e saj në zhvillimin e futbollit në Skenderaj dhe në të gjithë Kosovën.



MBAHET MBLEDHJA E PARË E KOMITETIT ORGANIZATIV TË LOJËRAVE MESDHETARE "PRISHTINA 2030"

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në mbledhjen e parë të Komitetit Organizativ të Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030".

Kurti i ka cilësuar këto lojëra si një nga projektet më të rëndësishme që Kosova do të realizojë në vitet e ardhshme, duke theksuar se për herë të parë vendi do të mirëpresë një ngjarje sportive të kësaj përmase.

Sipas tij, organizimi i Lojërave Mesdhetare do të sjellë në Kosovë sportistë, delegacione dhe partnerë nga vende të ndryshme të rajonit të Mesdheut, duke



krijuar një mundësi të rëndësishme për promovimin e vendit në arenën ndërkombëtare.

"Për Kosovën, kjo është një mundësi e jashtëzakonshme për të dëshmuar kapacitetin

tonë organizativ, për të avancuar sportin dhe infrastrukturën sportive dhe për ta prezantuar vendin tonë para një audience të gjerë ndërkombëtare", ka deklaruar Kurti.

Në fjalën e tij para anëtarëve të Komitetit Organizativ, kryeministri në detyrë ka theksuar se "Prishtina 2030" është një projekt me rëndësi shtetërore e kombëtare, i cili kërkon vizion afatgjatë,

bashkëpunim ndërinstitucional dhe angazhim të përbashkët.

Kurti ka thënë se suksesi i këtij projekti nuk do të vlerësohet vetëm përmes organizimit të një ngjarjeje sportive, por edhe përmes zhvillimit të infrastrukturës moderne, forcimit të institucioneve, krijimit të besimit të partnerit ndërkombëtarë dhe lënies së një trashëgimie të qëndrueshme për vendin. Ai ka shprehur përkushtimin e Qeverisë së Kosovës që procesi i organizimit të Lojërave Mesdhetare të udhëhiqet nga parimet e bashkëpunimit ndërinstitucional, transparencës, llogaridhënies dhe standardeve të larta të menaxhimit.

KOMBËTARJA U19 NË GRUMBULLIM TREDITORË NË HAJVALI

PRISHTINË, 5 GUSHT - Kombëtarja e Kosovës U19 është duke zhvilluar grumbullimin e radhës treditorë në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Ky grumbullim shërben si një etapë e rëndësishme përgatitore dhe seleksionuese për ndeshjet kualifikuese të Kampionatit Evropian që do të zhvillohen në nëntor në Gllasgow të Skocisë, ku Kosova në Grupin A2 do të përballlet me Belgjikën, Skocinë dhe Kazakistanin më 11, 14 dhe 17 nëntor.

Përzgjedhësi Albert Bunjaku ka theksuar se fokusi kryesor i këtij kampi është vëzhgimi i afërt i futbollistëve të ligës vendore, pa lënë anash edhe disa prurje nga jashtë. "Është një grumbullim seleksionues me lojtarë



vendorë. Ka qenë një dëshirë e imja të bëjmë këtë grumbullim, sepse edhe në kualifikimet në Turqi kemi pasur pesë lojtarë vendorë në formacionin startues. Kualiteti është i lartë,

stërvitja e parë ka shkuar shumë mirë me intensitet dhe përkushtim. Ne e kemi bazën e lojtarëve, por jemi duke kërkuar profile të caktuara lojtarësh që mund të na ndihmojnë në

kualifikimet e vështira që na presin në Skoci", ka thënë Bunjaku.

Atmosfera pozitive dhe motivimi i lartë vërehet edhe te vetë futbollistët e grumbulluar. "Është hera ime e parë me gjeneratën U19 dhe ndjenja është shumë e mirë. Grupi po duket mjaft i mirë dhe atmosfera është pozitive. E kemi kaluar mirë stërvitjen e parë, jemi ambientuar shpejt me pjesën tjetër të ekipit dhe stafin. Do të japim maksimumin tonë me shpresë se do të jemi pjesë e grupit përfundimtar për ndeshjet kualifikuese të nëntorit", ka thënë Unejs Mustafa.

Ndërsa Bleron Mustafa është shprehur i lumtur që pas një kohe rikthehet sërish në fanellën

dardane. "Është një ndjenjë shumë e mirë që jam rikthyer te Kombëtarja pas një viti e gjysmë për shkak të lëndimit. Jam krenar për këtë mundësi. Për çdo lojtar është ndjenjë e mirë kalimi nga U17 te U19 dhe synimi mbetet te Kombëtarja A. Ditën e parë e kemi kaluar shumë mirë, stërvitjet kanë qenë cilësore dhe atmosfera në ekip është e shkëlqyeshme", ka thënë Mustafa.

Kombëtarja U19 do të vazhdojë përgatitjet në Kampin Nacional edhe sot (e enjte), ku përzgjedhësi Albert Bunjaku me ndihmësit e tij, Besim Ademi, Anel Rashkaj dhe Labinot Qosa do të kenë mundësinë të vlerësojnë performancën e futbollistëve në këtë grumbullim.


Mohamed Salah transferohet te Trabzonspor

TRABZON, 5 GUSHT - Superylli egjiptian i futbollit, Mohamed Salah, do të vazhdojë karrierën te klubi turk Trabzonspor. Pas largimit nga Liverpooi,

Salah kishte disa oferta, por vendosi për transferimin te Trabzonspor, i cili i ka ofruar një kontratë të majme. Egjiptiani tashmë është nisur drejt Turqisë,

ndërsa janë publikuar edhe pamjet e para të tij me fanellën e klubit të ri. "Trabzon, a je gati? Ju dëgjoj!", ka thënë Salah në mesazhin e tij të parë për

tifozyt e Trabzonsporit. Sipas raportimeve, Salah do të përfitojë rreth 17 milionë euro në vit, ndërsa kontrata e tij do të jetë dyvjeçare.





Gjej PUNË

- Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria tregtare “AMICUS” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrh UNIK: 810844979 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klijenti da društvo sa "AMICUS" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810844979 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “AMICUS” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810844979 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgagor – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Qamil Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Gjergj Kastrioti" në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m."Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjumnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.


- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

